



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

Datë: 19/08/2019

**THIRRJE PËR APLIKIM
PËR SUBVENCIONIMIN E KAMATËS PËR KREDI PËR ZHVILLIMIN
AGRO BIZNESEVE**

Komuna e Vushtrisë gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ka hapur fazën e aplikimit për subvencionimin e kamatës për kredi për zhvillimin e agro bizneseve e për të gjithë të interesuarit.

Mënyra e shfrytëzimit të këtyre subvencioneve do të bëhet me financimin e agro bizneseve me kredi nga BKT, kurse kamatën e kredive për përfituesit e këtij projekti e paguan komuna në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me BKT 'në.

Andaj ftohen të gjithë të interesuarit e posaçërisht të rinjtë dhe të rejtat që duan të merren me zhvillimin e veprimtarisë agrobiznesore që të aplikojnë për këtë projekte të lartë shënuar :

Vlera e kredisë do të jetë minimumi 10.000,00€ dhe maximum 30.000,00Euro

Aplikuesit duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim;

- Aplikacionin;
- Të drejt aplikimi kanë personat mbi 18 vjet deri 65 vjet,
- Të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë si dhe veprimtarinë ta zhvillojë në Komunën e Vushtrrisë,
- Mjetet e kredituar të shfrytëzohen ekskluzivisht për investime Agro në veprimtari të ndryshme si në prodhimtari, përpunim, grumbullim etj.
- Investimet duhet të jenë në ato veprimtari që krijojnë të hyra afatgjate dhe punësim,
- Dëshminë kadastrale për pronësi të parcelës ku do të bëhet investimi(fleta poseduese),
- Të kenë parakushte për zhvillimin e asaj veprimtarie,
- Të kenë kapacitet për të kthyer mjetet e kredituara nga banka,
- Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve komunale;
- Planin investiv për marrjen e kredisë.

Aplikohet në zyrën pritëse të komunës;

Afati i fundit për aplikim 03/09/2019 ora 15:00

Vërejtje: Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve dhe tentimit për mashtrim do të aplikohen masa ndëshkimore duke mos i dhënë mundësi përfitimi për tre vitet e ardhshme.

Drejtori i DEBPZHR

Miran Halili